

GJYKATA THEMELORE MITROVICE DEGA NE VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, ne procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Veli Karaca nga Vushtrria, për kundërvajtje nga neni 17 paragrafi 1.3 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen, kontrollin e pasurise te zyrtareve te larte public dhe kontrollimin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar, duke u bazuar ne nenin 73,74,195 dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me daten 07.10.2013 bjen kete:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Veli Nazif Karacai lindur me 11.03.1958 ne Kurillove tani banon ne Vushtrri rr "Shales" nr. 10, sherbyes civil ne MPB, i martuar, ka te kryer akademin ushtarake, i gjendjes ekonomike mesatare, me pare jo i denuar.

ESHTE PERGJEGJES

SEPSE: i pandehuri Veli Karaca si zyrtar i larte public ne komunen e Vushtrris, ka qene i obliguar qe ta beje deklarimin e pasurise deri me daten 31.03.2012 per vitin paraprak dhe ta njoftoj Agjencion Kunder Korrupcionit, mirepo i njejti nuk e ka permbush obligimin ligjor te parapar me ligjin per deklarimin prej ardhjen dhe kontrollimin e pasurise.

Me kete veprim ka kryer kundervajtje mos deklarim i pasurise nga neni 17 paragrafi 1.3 Ligjit per deklarimin, prejardhjen, kontrollin e pasurise te zyrtareve te larte public dhe kontrollimin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar.

dhe conform nenit 9 te LMK-es:

DENOHET

Me denim me gjobe ne shume prej 400 / katerqind / €, te cilen gjobe i pandehuri eshte i obliguar qe ta paguaj ne afat prej 15 ditesh nga data e plotefuqishmerise se ketij Aktvendimi, nese gjoben e shqiptuar nuk e paguan ne afat prej 15 ditesh e njejta konforme nenit 5 te Ligjit mbi kundërvajtjet do ti zavendesohet me denim burgu ne kohezgjatje prej 26 dite, duke e llogaritur nga 15 € per nje dite burg.

Konforme nenit 109 paragrafi 2 te Ligjit mbi kundervajtje i pandehuri eshte i obliguar qe ne emer te paushallit gjyqesor te paguaj shumen prej 10 € ne te njejten afat me gjoben.

Nga nje kopje te ketij atkvendimi duhet te dergohet paleve.


Arsyetim

Agjencioni Kunder Korrupcionit Prishtine ka paraqitur kerkesen nr. 01-2542/12 dt. 02.08.2012 per inicimin dhe zhvillimin e procedures kundervajtëse kunder te pandehurit Veli Karaca nga Vushtrria, per kundervajtjen e pershkruar ne dispozitiv te aktvendimit.

I pandehuri Veli Karaca eshte denuar me gjobe ne shume prej 1000 € me Aktvendimin 7791/12 te dt. 23.10.2012 mirepo i njejti ne afatin ligjor ka parashtruar ankese ashtuqë nga Gjykata e Larte per Kundervajtje ne Prishtine, ankesa e te pandehurit eshte aprovuar, aktvendimi i kesaj gjykate eshte abroguar dhe lenda eshte kthye ne rivendosje duke na njoftuar me faktet te cilat duhen te sigurohen dhe te plotesohet procedura duke e marre ne pyetje ushtruesin e kerkeses, dhe personin zyrtar kontaktues, gjyqtari veproj sipas udhezimeve dhe keshillave te Gjykates se Larte dhe i muarr ne pyetje personat e cekur.

Ne baze te kerkeses se parashtruar gjyqtari e inicioj proceduren per kundervajtje me marrjen ne pyetje te pandehurit me c'rast i njejti deklaroi: une nuk kam qene i informuar nga Agjencioni Kunder Korrupcionit per faktin qe duhet me mbushe nje formular te cakuar per ti dhan informata per pasurin time si antar i kuvendit ndersa me par une kam qene anare i kuvendit dy mandate dhe formularet i kam plotesue ne fillim te mandatit ndersa gjendja ime ekonomike nuk ka ndryshuar sepse une jetoj ne familje me gjaste antare me nje page mujore si sherbyes civil dhe nuk posedoi kurfare biznesi e as pasurie tjeter dhe kam konsiderue se nuk eshte e nevojshme perseritja e t'dhanave te mia lidhur me pasuri dhe nuk e kam dite qe ligji ri na obligon qe ta kryejme kete obligim, kurse me vone jam informue permes WEB faqes se komunes se egziston nje formular per deklarimin e pasurise.

Dep.	DPK/DMP	03-3416/13
Dep.		
Pr.		
Proj. / Titull	02	18.10.2013
Kr. / Nr. / Data		



03-3416/13/02
Saj

Per vertetimin e drejte dhe te plote te gjendjes faktike jane marre ne pyetje Agron Behrami perfaqesues i autorizuar i AKK i cili ka deklaruar: se kunder te pandehurit Veli Karaca nga Vushtrria AKK ka ushtruar kerkese per kundervajtje per shkak se i njejti zyrtar ka pas per obligim ne baze te ligjit qe ta beje deklarimin e pasurise deri me 31.03 te vitit vijues mirepo, i njejti kete nuk e ka bere e sa i perket njoftimit me formularin te cilen e ka pas per obligim qe ta mbushë dhe t'na sjelle neve per kete e kemi zyrtarin kontakues i cili e ka per obligim qe ti njoftoi zyrtaret e larte public per procesin e deklarimit te pasurise, dhe nga kjo konstatoi se njoftimi me formular është bere ne menyre te rregullt kurse sa i takon kualifikimit juridik mendoj se është i drejt aj qe e kemi dhan ne kerkesen kundervajtese.

Deshmitari Ilmi Zeqiri zyrtar kontaktes i caktuar nga Kuvendi i Komunes per te pas kontakte me AKK Prishtine, per te gjitha ceshtjet qe duhet te mirren ne detyren time ne drejtim te kontaktimit me personat - zyrtar public te komunes une ju kam drejtue sekretaris se kuvendit qe me kohe te gjithë personat qe figurojne ne listen e zyrtareve te larte public tua dergojne njoftimin, gjegjesisht formularet per deklarimin e pasurise dhe jam i bindur se kete e kane kryer dhe nuk besoi qe Veli Karaca ka mbet pa u njoftue sepse kjo nuk është hera e pare qe ky person është dashte ta kryej kete pune.

Ne baze te kerkeses per fillimin e procedures kundervajtse deklarave te deshmitareve dhe shkresave tjera te landes gjyqtari ne menyre te plote dhe te drejte e vertetoi gjendjen faktike dhe konstatoi se i pandehuri nuk e ka bere deklarimin e pasurise dhe nuk e ka njoftue AKK ne Prishtine, e me kete i nejeiti ka kryer kundervajtje mos deklarim i pasurise nga neni 17 paragrafi 1.3 te Ligjit per deklarimin e pasurise.

Pas administrimit te provave ne shkresat e landes dhe vleresimit te deklarates perfaqesuesit te autorizuar te kerkeses dhe provave tjera ne shkresat e landes ka konstatuar dhe vertetuar ekzistimin e kundervajtjes se kryer nga ena e te pandehurit dhe per kete është shpall pergjegjes dhe i është shqiptuar denimi me gjobe si ne dispozitiv te aktvendimit kurse me rastin e caktimit te denimit jane vlersuar rrethanat ne te cilat është kryer kundervajtja, shkalla e pergjegjesise se te pandehurit, sjellja e tij ne gjykate, gjendja e tij ekonomike dhe qe kjo është kundervajtja e pare ashtuqë, duke u bazuar ne keteo rrethana gjyqtari ne pajtim me nenin 9 te Ligjit mbi kundervajtjet te pandehurit ja shqiptoi denimin nen minimumin ligjor duke qene i bindur se denimi i shqiptuar do te ndikoi qe i njejti ne te ardhmen mos ta perseris nje kundervajtje te tille.

Me sa u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICE DEGA NE VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjesdt. 07.10.2013

Gjyqtari
Emrush Potoku

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi mund te parashirojne i pandehuri dhe ushtruesi i kerkeses ne Gjykatën e Apelit ne Prishtine - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundervajtjes, ne afat prej 8 dite, nga dita e pranimit te ketij aktvendimi permes kesaj gjykate